



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM**  
**TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Nr. \_\_\_\_ Prot., Datë \_\_\_\_.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**IMPORTUESI FARMACEUTIK**

---

Nr. \_\_\_\_ Prot., Datë \_\_\_\_.

## **KONTRATË**

**“PËR QARKULLIMIN E BARNAVE TË LISTËS SË BARNAVE QË**  
**RIMBURSOHEN NGA IMPORTUESI FARMACEUTIK”**

**Ndërmjet**

**FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**

**Dhe**

**IMPORTUESIT FARMACEUTIK \_\_\_\_\_**

Kjo Kontratë nënshkruhet në \_\_\_\_\_, në datë \_\_\_\_\_  
ndërmjet:

Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, (në vijim “Fondi”), përfaqësuar nga Z/Znj. \_\_\_\_\_, Drejtor i Përgjithshëm,

dhe

Importuesit Farmaceutik \_\_\_\_\_ (në vijim “Importuesi”), me të dhënat e mëposhtme:

Kodi i identifikimit nga Fondi \_\_\_\_\_,

Liçencë të Qendrës Kombëtare të Biznesit ( në vijim QKB) nr. \_\_\_\_\_,

NIPT/NUIS nr. \_\_\_\_\_,

Adresa/ Adresa sekondare e Importuesit \_\_\_\_\_,

nr. telefoni \_\_\_\_\_ adresa elektronike \_\_\_\_\_,

Person juridik/fizik, ortak i vetëm/administrator/përfaqësues ligjor, Z/Znj. \_\_\_\_\_

me drejtues teknik Z/Znj. \_\_\_\_\_ me çertifikatë të Urdhrit të Farmacistëve nr. \_\_\_\_\_

### **Dispozita paraprake**

Duke qenë se:

A. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e zhvillon aktivitetin në zbatim të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

B. Në bazë të ligjit të sipërcituar, Fondi lidh kontrata me dhënësit e shërbimit shëndetësor për dhënien e shërbimeve shëndetësore të përfshira në paketat e shërbimeve, ku bën pjesë Lista e Barnave të Rimbursuara, (në vijim LBR), e miratuar nga Këshilli i Ministrave;

C. Importuesi është njësi tregtare farmaceutike që furnizohet nga prodhuesit ose mbajtësit e autorizuar për tregtim për realizimin e importit të barnave, e që tregton me shumicë barnat e Listës së Barnave të Rimbursueshme në bazë të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”;

D. Importuesi ka përmbushur kriteret për lidhjen e kontratave me Fondin, si dhe ka paraqitur gjithë dokumentacionin e kërkuar për lidhjen e kontratave, në përputhje me vendimin e Këshillit Administrativ të Fondit nr. 72, datë 22.12.2015, i ndryshuar;

E. Këshilli Administrativ i Fondit, ka miratuar kontratën tip “Për qarkullimin e barnave të Listës së Barnave që Rimburohen nga importuesi farmaceutik”, me VKA nr. 19, datë 31.07.2024.

F. Kushtet e kësaj kontrate janë në vazhdimësi të marrëdhënieve të mëparshme, sipas kontratave të lidhura midis Fondit dhe Importuesit që nga viti \_\_\_\_\_.

palët e mësipërme bien dakord si vijon:

### **Neni 1**

#### **Objekti i kontratës**

Objekt i kësaj kontrate është importimi, shpërndarja, shitja me shumicë dhe kontrolli i qarkullimit të barnave të listës së barnave që rimburohen me çmime të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe sigurimi i disponibilitetit të tyre në tregun e hapur farmaceutik.

### **Neni 2**

#### **Baza ligjore**

Për hartimin dhe zbatimin e kësaj kontrate palët i referohen dhe mbështeten mbi bazën ligjore që vijon:

1. Ligji nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Ligji nr. 105/2014, datë 31.07.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar.
3. Ligji nr. 7975, datë 20.07.1995, “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, i ndryshuar.
4. Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil”, i ndryshuar.
5. Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.
6. Ligji nr. 9150, datë 30.10.2003, “Për Urdhërin e Farmacistëve”, i ndryshuar.
7. Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
8. Ligji nr. 10107, datë 30.03.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
9. Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
10. Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
11. Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar.
12. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.
13. Ligji nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar.
14. Ligji nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurës Administrative”.
15. Ligji nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar.
16. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 144, datë 11.02.2009, “Për miratimin e formularëve të vetëdeklarimit, për të ushtruar veprimtarinë e tregtimit me shumicë të barnave, të tregtimit në farmaci dhe agjenci farmaceutike, si dhe të import-eksportit të tyre”.

17. Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 491, datë 24.07.2024 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre”
18. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.252 , datë 29.04.2022 “Për procedurën e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”,
19. Vendimi i Këshillit Administrativ nr. 34, datë 12.12.2019, “Për miratimin e rregullores mbi procedurat e përshkrimit, gjenerimit, ekzekutimit, kontrollit dhe rimbursimit të recetës elektronike e-Rx”.
20. Vendimi i Këshillit Administrativ nr. 72, datë 22.12.2015, “Për kriteret që duhet të plotësojnë importuesit dhe shpërndarësit farmaceutikë për lidhjen e kontratës me Fondin dhe procedurat për lidhjen e kontratës”, i ndryshuar.
21. Vendim i Këshillit Administrativ Nr. 101, datë 22.10.2014, për miratimin e Rregullores nr. 3 “Për procedurën dhe mënyrën e kontrollit të dhënësve të shërbimit të kontraktuar me Fondin”, e ndryshuar.
22. Udhëzimi nr. 16, datë 03.04.2020, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.
23. Udhëzimi nr. 20, datë 01.06.2020, “Për elementet bazë dhe teknike, lëshimin dhe shkëmbimin e faturave elektronike dhe faturave shoqëruese”.

### Neni 3

#### **Kriteret që duhet të përmbushë Importuesi**

1. Importuesi të jetë i licencuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit.
2. Importuesi të jetë i regjistruar pranë QKB.
3. Importuesi të importojë dhe të tregtojë barna të listës së barnave që rimbursohen, të regjistruara ose me leje importi.
4. Drejtuesi teknik i importuesit të jetë pajisur me certifikatën përkatëse të Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë.
5. Drejtuesi teknik i importuesit të drejtojë vetëm depon për të cilën është licencuar.
6. Importuesi të përdorë sistemin online të Depove Farmaceutike (e-Depo), për regjistrimin e të dhënave për qarkullimin e barnave të Listës së Barnave të Rimbursuara.
7. Përveç plotësimit për sa parashikohet më sipër, nuk lidhet kontratë me asnjë Importues, (person juridik/fizik, ortak i vetëm/administrator/përfaqësues ligjor apo drejtues teknik), i cili:
  - është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

#### **Neni 4**

#### **Barnat e tregtuara nga Importuesi**

1. Importuesi do të realizojë importimin dhe shitjen me shumicë të barnave që rimbursohen, të importuara nga firmat farmaceutike sipas anekseve nr. 1 deri nr. \_\_\_\_ bashkangjitur kësaj kontrate, e që janë pjesë e saj.
2. Anekset bashkangjitur kësaj kontrate, janë objekt rishikimi nga palët, çdo herë që do të ketë ndryshime të LBR, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.
3. Importuesi do të realizojë edhe shitjen me shumicë të barnave të furnizuara nga importues të tjerë farmaceutik, tek shpërndarësit farmaceutik dhe farmacitë/agjencitë farmaceutike.
4. Importuesi farmaceutik për barnat e rimbursueshme, të furnizohet vetëm nga importuesit/shpërndarësit farmaceutik që kanë kontratë me Fondi-n, në të kundërt faturat hyrëse nuk do t'i merren në konsideratë gjatë procesit të kontrollit.
5. Në rast se importuesi, do të importojë dhe tregtojë barna të tjera të listës që nuk parashikohen në anekset e kësaj kontrate, me kërkesën me shkrim nga ana e importuesit dhe me pëlqimin e dy palëve, do të hartohen anekse shtesë, të kësaj kontrate, sipas afateve të përgjithshme të lidhjes së kontratave me Fondin.
6. Importuesit farmaceutik, barnat e rimbursueshme, të cilat nuk i ka deklaruar në anekset e kësaj kontrate, nuk do t'i merren në konsideratë për efekt kontrolli me inventar në faturat dalëse të tij.
7. Importuesi duhet të furnizojë farmacitë/agjencitë farmaceutike të kontraktuara me barnat e listës së barnave të rimbursueshme, në lloje/artikuj, vetëm nëpërmjet transmetimit 100% në sistemin e-Depo dhe vetëm sipas kërkesës së tyre.
8. Importuesi duhet të tregtojë barnat e Listës së Barnave që rimbursohen, vetëm të pajisura me pullën e kontrollit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM-së) dhe brenda serisë dhe skadencës së deklaruar.

#### **Neni 5**

#### **Alternativat e para dhe alternativat e vetme të barnave të LBR**

1. Importuesi siguron disponibilitetin në tregun farmaceutik të alternativave të vetme dhe të alternativave të para të barnave të LBR, që bëjnë pjesë në anekset e kësaj kontrate. Në kuptim të kësaj kontrate, disponibiliteti i barit do të thotë që, importuesi duhet të ketë gjëndje një sasi bari alternative e vetme për të mbuluar nevojat e tregut (sa konsumi mesatar 2 (dy) mujor i barit në rang vendi. Për barnat alternativë e parë, importuesi duhet të ketë gjëndje një sasi bari sa konsumi mesatar 1 (një) mujor i barit në rang vendi, konsum i bazuar në të dhënat e publikuara në faqen zyrtare te Fondit.
2. Disponibiliteti konstatohet në rjetin e hapur farmaceutik dhe/ose nga informacioni i vetëdeklaruar nga importuesi pranë Fondit, në mënyrë shkresore ose nëpërmjet sistemit e-Depo.

3. Në rast se importuesi, konstaton ose parashikon mungesa të barit për periudha dhe sasi më të mëdha se disponibiliteti i kërkuar, është i detyruar të lajmërojë paraprakisht Fondin, në adresën: [info@fsdksh.gov.al](mailto:info@fsdksh.gov.al). Lajmërimi të shoqërohet me argumenta dhe dokumenta justifikues dhe provues, në origjinal ose të njësuara me origjinalin për vonesën e pritur.
4. Verifikimi për disponibilitetin e barnave alternativë e parë dhe/ose të vetme, do të bëhet nga Fondi, vetëm pas një periudhe 60 ditësh nga hyrja në fuqi e LBR.
5. Në rast se importuesi vërteton me dokumentacion justifikues dhe provues, në origjinal ose të njësuara me origjinalin që mungesa e disponibilitetit të barit në treg, nuk rrjedh si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të tij, por për shkaqe që varen nga MAT, (Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim), siç janë shkaqet:
  - a) të identifikuar gjatë procesit të prodhimit nga MAT-ja;
  - b) të transportit për arsye të pajustificuara nga MAT-ja;
  - c) të rasteve të forcave madhore, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;Në rast të mosparaqitjes së dokumentacionit justifikues dhe provues në origjinal ose të njësuar me origjinalin, për shkaqet e cituara në shkronjat a ose b, lajmërimi konsiderohet i paplotë, pavarësisht njoftimit në adresën [info@fsdksh.gov.al](mailto:info@fsdksh.gov.al). Në këto kushte, importuesi nuk përjashtohet nga penalitetet e kësaj kontrate.
6. Importuesi duhet të vërtetojë me dokumentacion justifikues dhe provues në origjinal ose të njësuar me origjinalin që mungesa e disponibilitetit të barit në treg nuk rrjedh si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të tij po për shkaqe të vonesës së pajisjes me pullë të barit nga AKBPM.  
Në rast të mosparaqitjes së dokumentacionit justifikues dhe provues në origjinal ose të njësuar me origjinalin për shkakun e cituar më sipër, lajmërimi konsiderohet i paplotë, pavarësisht njoftimit në adresën [info@fsdksh.gov.al](mailto:info@fsdksh.gov.al). Në këto kushte importuesi nuk përjashtohet nga penalitetet e kësaj kontrate.
7. Në rastet kur importuesi lajmëron në mënyrë shkresore Fondin, për tërheqje nga tregu, ose revokim të autorizimit për tregtim të barit alternativë e parë dhe/ose e vetme në LBR në fuqi, importuesi përjashtohet nga penalitetet e kësaj kontrate, në lidhje me disponibilitetin e barit në treg, deri në hyrjen në fuqi të LBR-së së re.

## Neni 6

### Çmimet e tregtimit të barnave

Importuesi është i detyruar të zbatojë çmimet e barnave të Listës së Barnave që Rimbursohen në fuqi, si dhe reflektimin e ndryshimeve të saj, për kohën që zgjat kjo kontratë.

## Neni 7

### Ndryshimet në të dhënat ose aktivitetin e importuesit

1. Në rastin e ndryshimit të licencës së ushtrimit të aktivitetit, drejtuesit teknik, të personit juridik/fizik, ortak i vetëm/administrator/përfaqësues ligjor të importuesit, duhet të

njoftohet me shkrim Fondi brenda 7 (shtatë) ditëve pune. Personi juridik/fizik, ortaku i vetëm/administratori/përfaqësuesi ligjor i ri i importuesit, e ushtron aktivitetin e tij brenda afatit të kontratës së mëparshme dhe mbart në vazhdimësi të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kjo kontratë deri në përfundim të saj.

2. Importuesi ka detyrimin për të deklaruar hapjen e filialeve të reja me të njëjtin numër NIPT-i dhe adresë sekondare.
3. Importuesi që ndryshon vendndodhje, duhet të njoftojë për këtë ndryshim Fondin, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga data e ndryshimit.
4. Kur importuesi ndërpret aktivitetin, për më shumë se 3 (tre) ditë pune, duhet të lajmërojë me shkrim ose në mënyrë elektronike Fondin, për kohën e ndërprerjes, në adresën e Email: info@fsdksh.gov.al.

## Neni 8

### Administrimi i dokumentacionit të importuesit

1. Shitja e barnave të rimbursueshme nga importuesi të bëhet me faturë të fiskalizuar.
2. Monedha e përdorur do të jetë vetëm leku shqiptar.
3. Importuesi është i detyruar të mbajë në rregull dokumentacionin si më poshtë:
  - a) inventarin e gjendjes fizike të barnave të listës së barnave që rimburohen, të gjeneruar nga sistemi nga e-depo, në momentin e hyrjes në fuqi të listës së barnave që rimburohen dhe kur kërkohet nga Fondi;
  - b) faturat e hyrjes nga importi të barnave që rimburohen, të shoqëruara me lejen e përdorimit;
  - c) faturat e hyrjes nga importues dhe shpërndarës të tjerë farmaceutik;
  - d) faturat e daljes së barnave që rimburohen sipas pikave 1 dhe 2 të mësipërme;
  - e) programin kompjuterik e-depo i instaluar nga Fondi.
4. Importuesi është i detyruar të ruajë dokumentacionin e pikës 3, për një periudhë kohore sipas legjislacionit në fuqi dhe t'i vërë në çdo kohë në dispozicion të Fondit.

## Neni 9

### Dorëzimi dhe regjistrimi i inventarëve

Importuesi vetëdeklaron duke ngarkuar në platformën e-Albania, shërbimet e Fondit, inventarin e gjendjes fizike të barnave që rimburohen, inventarin e barnave të skaduara (nëse ka), listën e barnave Anekset 1- \_\_\_\_, kur lidh kontratë, kur hyn në fuqi lista e barnave që rimburohen dhe kur kërkohet nga Fondi, të printuar dhe në formë elektronike, si dhe autorizimin (ose kontratën) nga Mbajtësi i Autorizuar për Tregtim, vendas apo i huaj, për tregtimin e barnave në Shqipëri. Inventari i gjendjes fizike të barnave ekzistuese në çelje të jetë i njëjtë me gjendjen e inventarit në mbyllje.

## **Neni 10**

### **Krijimi i aksesit në programet dhe dokumentacionin e sigurimeve shëndetësore**

Fondi ka për detyrë të pajisë importuesin me listën e barnave që rimbursohen, me aktet nënligjore të sigurimeve shëndetësore që lidhen me veprimtarinë e importuesit, si dhe me programet informatike të Fondit.

## **Neni 11**

### **Kontrolli nga Fondi**

1. Fondi realizon monitorimin dhe kontrollin e barnave të listës së rimbursimit nga Importuesit, përmes të dhënave të sistemit informatik e-depo dhe problematikave që lidhen me këto barna.
2. Importuesi është i detyruar të dorëzojë dokumentacionin hyrje-dalje kur i kërkohet nga kontrolli i Fondit, si dhe po ky dokumentacion rikthehet tek importuesi brenda afatit kohor prej 1 (një) muaji.
3. Specialistët e Fondit, me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm, kanë të drejtë të bëjnë kontroll të gjendjes fizike dhe të dokumentacionit të barnave të listës që rimbursohen që tregtohen nga importuesi për:
  - a) Saktësinë e inventarit të deklaruar nga importuesi për barnat e reja të LBR-së;
  - b) Mospërputhje në sistemin e-depo mes sasive të barnave që rimbursohen të qarkulluara nga importuesit, sipas raportimeve të tyre, me të dhënat e rimbursimit dhe të konsumit.
  - c) Problematika të tjera të identifikuar nga sistemi.
4. Specialistët e Fondit, kanë të drejtë të bëjnë kontroll për çdo rast të evidentuar me shkrim ose postë elektronike, për mosfurnizim ose furnizim të detyruar të importuesit ndaj farmacive/agjencive farmaceutike të kontraktuara për barnat e listës së rimbursueshme;
5. Fondi i njëj importuesit, për efekt të llogaritjeve, çdo dokument ose procesverbalin të lëshuar nga autoritetet kompetente, lidhur me barnat e nxjerra jashtë përdorimit, të dëmtuara, të asgjësuara, etj.
6. Grupi i kontrollit realizon ballafaqimin me administratorin/drejtuesin teknik/farmacistin e lartë, përpara nxjerrjes së proces-verbalit përfundimtar dhe akt-rekomandimit.

## **Neni 12**

### **Detyrimet e Fondit lidhur me garantimin e rimbursimit të barnave të kontraktuara me importuesin**

1. Fondi merr përsipër t'ju rimbursojë farmacive/agjencive vetëm barnat e listës së barnave që rimbursohen të pajisura me pullën e kontrollit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të tregtuara nga importuesi ose/dhe shpërndarësi që ka kontratë me Fondin, sipas serive e skadencave që pasqyrohen në faturat e shitjes të lëshuara nga importuesi.



2. Fondi është i detyruar të informojë gjithë shpërndarësit, farmacitë dhe agjencitë farmaceutike për importuesit që kanë kontratë me Fondin.
3. Fondi është i detyruar t'i japë të dhëna importuesit, në mënyrë elektronike/me shkrim, të konfirmuara, lidhur me konsumin e barnave që rimbursohen të Anekseve të kësaj kontrate, çdo muaj.
4. Kur konstatohet se, janë rimbursuar barna jashtë serive të deklaruara nga importuesi, të sjella nga burime të pa kontraktuara nga Fondi ose barna që nuk janë objekt i kësaj kontrate, Fondi duhet të njoftojë importuesin lidhur me këtë konstatim, si dhe për subjektet përgjegjëse të marrë masa administrative deri në kallëzim penal.

### **Neni 13**

#### **Komunikimi mes palëve**

1. Fondi dhe Importuesi bien dakord të bëjnë takime të përbashkëta për të ballafaquar të dhënat që kanë palët dhe për sqarimin e problemeve të lindura gjatë zbatimit të kontratës.
2. Palët, gjatë veprimtarisë së tyre, janë të detyruar të respektojnë ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, në përputhje me kriteret e përpunimit të këtyre të dhënave, sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

### **Neni 14**

#### **Gjoba**

1. Kur nga kontrolli i gjendjes fizike të barnave të rimbursueshme, tek Importuesi, rezultojnë diferenca në plus të pajustificuara, (gjendja fizike është më e madhe se gjendja kontabël), importuesi paguan gjobë të barabartë me dyfishin e tepicës së konstatuar.
2. Kur importuesi nuk pranon specialistët e Fondit, të cilët janë të pajisur me fletë identifikimi dhe urdhërin përkatës, pa arsye të paraqitura me shkrim, ai paguan gjobë në vlerën 1,000,000 (një milionë) lekë.
3. Kur nga kontrolli rezulton se, importuesi nuk ka transmetuar në sistemin e-Depo fatura hyrje/dalje, paguan gjobë në vlerën 10,000 (dhjetë mijë) lekë për çdo faturë hyrje/dalje të konstatuar.
4. Importuesi, për mosdeklarim të detyrimeve që rrjedhin nga pikat 1, 2, 3, të nenit 7 “Ndryshimet në të dhënat ose aktivitetin e importuesit”, deri në fund të muajit pasardhës, paguan gjobë në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë
5. Kur importuesi, nuk njofton në Fond, për ndërprerjen e aktivitetit për më shumë se 3 (tre) ditë pune, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 7, paguan gjobë në vlerën 1,000,000 (një milionë) lekë.
6. Kur nga kontrolli i ushtruar, konstatohet se, në ambjentet e importuesit farmaceutik mbahen barna që kanë mospërputhje ndërmjet serisë së vendosur në kutinë e barit dhe serisë së vendosur në pullën e kontrollit të AKBPM (të pa shoqëruar me dokumentin

përkatës justifikues), importuesi farmaceutik paguan gjobë në vlerën 20,000 (njëzet mijë) lekë për çdo paketim.

7. Për çdo rast të evidentuar me shkrim ose postë elektronike, për mos furnizim ose furnizim të detyruar të importuesit ndaj farmacive/agjencive farmaceutike të kontraktuara, me barnat e listës së barnave të rimbursueshme, në lloje/artikuj, importuesi paguan gjobë në 100,000 (njëqind mijë) lekë, për çdo rast.
8. Kur nga kontrolli rezulton se, importuesi ka shitur barna që nuk korrespondojnë me serinë dhe skadencën e deklaruar nga ai në sistem, paguan gjobë në vlerën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për çdo rast.
9. Procedura e konstatimit, vendosjes dhe ekzekutimit të gjobës bëhet në përputhje me ligjin, nr.10279 datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”.

### **Neni 15 Kusht Penal**

1. Në rast të mosinformimit dhe mosjustifikimit të mungesës së barnave alternativa të para në treg nga ana e importuesit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 5, Importuesi paguan kushtin penal në vlerë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekë, në rastin e dytë të evidentuar, Importuesi paguan kushtin penal prej 1 000 000 (një milion) lek. Në rastin e përsëritur, propozohet për heqjen e atij bari nga LBR dhe kalimin në alternativa pasardhëse, me kushtin që importuesi të mbulojë diferencën e çmimit nga alternativa e parë tek alternativa pasardhëse zëvendësuese.
2. Në rast të mosinformimit dhe mosjustifikimit të mungesës së barnave alternativa të vetme në treg, në kundërshtim me parashikimet e nenit 5, Importuesi paguan kushtin penal në vlerë prej 1 000 000 (një milion) lekë, në rastin e dytë të evidentuar Importuesi paguan kushtin penal në vlerë prej 2 000 000 (dy milion) lek. Në rastin e përsëritur, importuesit nuk do ti jepet e drejta të tregtojë barin e munguar, për llogari të Fondit në kontratën e ardhshme të lidhur mes importuesit dhe Fondit.

### **Neni 16 Mospranimi i dokumentacionit**

Në rast se dokumentacioni (faturë hyrje/dalje, etj.), nuk është sipas formatit dhe kërkesave të ligjit nr. 87/2019, “Për faturat dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, nuk do të merren në konsideratë gjatë verifikimit të gjendjes fizike nga Fondi dhe nuk do t’u njihen subjekteve farmaceutike (importues, shpërndarës, farmaci, agjenci) si të tilla.

### **Neni 17**

#### **Moslidhja e kontratës**

1. Importuesi (person juridik/fizik, ortak i vetëm/administrator/përfaqësues ligjor apo drejtues teknik), i cili është dënuar me një vendim të formës së prerë, nuk gëzon të drejtën të lidhë kontratë me Fondin.

### **Neni 18**

#### **Zgjidhja e kontratës**

Zgjidhja e kontratës bëhet për shkaqet e mëposhtme:

1. Ka përfunduar afati për të cilën ajo është lidhur ose ka përfunduar afati i vlefshmërisë së Licencës së Importuesit.
2. Mbyllet ose pezullohet aktiviteti me një akt të organeve kompetente.
3. Kur vërtetohen raste të daljeve fiktive të bëra nga importuesi. Në këtë rast, bëhet njoftimi për ndjekje penale.
4. Kur konstatohet se, vazhdohet të furnizojnë barna jashtë serisë, skadencës dhe sasisë të deklaruara nga importuesi në sistem edhe pas vendosjes së penalteteve.
5. Për raste të përsëritura për tregtimin e barnave mbi çmimet e LBR, të zgjidhet kontrata për një periudhë jo më pak se 1 vit.
6. Kur nga verifikimi i gjendjes fizike të barnave të rimbursueshme, tek importuesi, rezultojnë diferenca në plus të pajustificuara, (gjendja fizike është më e madhe se gjendja kontabël), me vlerë në masën e 10% të vlerës totale të shitur, për barnat e inventarizuara, rast i përsëritur, importuesit i zgjidhet kontrata nga dita e njoftimit zyrtar deri në fund të periudhës së kontraktimit, por jo më pak se një periudhë 6 (gjashtë) mujore nga koha e zgjidhjes.
7. Për deklaram të rremë, importuesit i zgjidhet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se një periudhë 6 (gjashtë) mujore nga koha e zgjidhjes.
8. Importuesit i zgjidhet kontrata, për mosdeklarim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 7, “Ndryshimet në të dhënat ose aktivitetin e Importuesit”, përtej afatit të parashikuar në pikën 5, të nenit 14, “Gjoba”.
9. Nëse përgjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, Importuesi dënohet me një vendim të formës së prerë, i zgjidhet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar.

### **Neni 19**

#### **Proçedura dhe pasojat e zgjidhjes së kontratës**

1. Në të gjitha rastet, zgjidhja e kontratës bëhet me njoftim zyrtar, ku përshkruhet edhe arsyeja e zgjidhjes.

2. Faturat e barnave të rimbursueshme të lëshuara nga importuesi, pas datës së zgjidhjes së kontratës, nuk do t'u njihen importuesve/shpërndarësve të tjerë dhe as farmacive për efekt inventari, si dhe nuk rimbursohen nga Fondi.
3. Në rast të mbarimit të afatit të kontratës dhe mos aplikimit për rilidhje në vazhdimësi, importuesi farmaceutik nuk gëzon të drejtën e lidhjes së kontratës për një periudhë 1 (një) vjeçare.
4. Në rast të zgjidhjes së kontratës përpara mbarimit të afatit, nga ana e Importuesit, ai nuk gëzon të drejtën e lidhjes së kontratës për një periudhë 1 (një) vjeçare.

## **Neni 20**

### **Ankimi Administrativ**

1. Subjekti ose personi përgjegjës, ndaj të cilit është vendosur një sanksion, sipas parashikimeve të kësaj kontrate, ka të drejtën e ankimit pranë Komitetit të Shqyrtimit Administrativ të Fondit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga marrja dijani e vendimit me sanksionin përkatës.
2. Ankimi administrativ, duhet të përmbajë këto elemente:
  - a) subjektin që ushtron ankimin me të dhënat identifikuese dhe adresën e tij;
  - b) procedurën konkrete për të cilën paraqitet ankimi;
  - c) një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar dhe bazën ligjore përkatëse;
  - d) pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar;
  - e) provat dhe dokumentacionin përkatës, të cilat kërkohen të shqyrtohen nga Komiteti i Shqyrtimit Administrativ të Fondit.
3. Komiteti i Shqyrtimit Administrativ i Fondit, shqyrton brenda 30 (tridhjetë) ditëve, ankimin e paraqitur, në përputhje me kërkesat e pikës 2, të këtij neni, por jo më vonë se afati i përfundimit të procedurës administrative.
4. Ankimi administrativ i paraqitur, në përputhje me kërkesat e këtij neni, pezullon ekzekutimin e vendimit, deri në vënien në dijeni të ankuesit me vendimin e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ të Fondit.
5. Kundër vendimit të Komitetit të Shqyrtimit Administrativ të Fondit, subjekti mund të depozitohet ankimin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë ku ka juridiksionin.

## **Neni 21**

### **Ndryshimet e kontratës**

1. Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me shkrim, me vullnetin dhe me pëlqimin e të dyja palëve.

2. Çdo ndryshim, shtesë ose shfuqizim i plotë ose i pjesshëm i kësaj kontrate, nuk do të ketë fuqi nëse nuk është kryer me shkrim dhe nënshkruar nga palët kontraktuese/përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve.

## **Neni 22**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Palët kontraktuese respektojnë legjislacionin shqiptar në fuqi dhe përpiqen që mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë realizimit të kontratës, t'i zgjidhin me mirëkuptim midis tyre.
2. Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër, duke bërë një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.
3. Palët kontraktuese të përfshira në mosmarrëveshje, duhet të bëjnë personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mbi parimin e ruajtjes së vazhdimësisë së punës.
4. Nëse palët kontraktuese apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar, nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit apo për një kohë më të gjatë të miratuar nga palët, njëra palë njofton palën tjetër se çështja nuk është zgjidhur.
5. Për të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, ku ushtron aktivitetin.

## **Neni 23**

### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo kontratë lidhet me afat deri në hyrjen në fuqi të LBR-së së re. Ky afat mund të ndryshojë me miratimin e përbashkët me shkrim të palëve.
2. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i shtrin efektet e saj nga data \_\_\_\_\_.
3. Kjo kontratë është përpiluar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe secila nga palët mban nga një kopje.
4. Kontrata pasi u lexua nga palët, u konsiderua e redaktuar sipas pëlqimit të tyre dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të lirë e të pavesuar.

Kjo kontratë firmoset nga:

**Për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor**

..... Emri, Mbiemri dhe firma e Drejtorit të Përgjithshëm  
të Fondit

**Për Importuesin Farmaceutik** \_\_\_\_\_

..... Emri, Mbiemri dhe firma e personit juridik/fizik,  
ortak i vetëm/administrator/përfaqësues ligjor

## ANEKSI Nr. 1

Importuesi \_\_\_\_\_, mbështetur në autorizimin/kontratën e Mbajtësit të Autorizimit për Tregtim/Prodhuësit Farmaceutik: \_\_\_\_\_, merr përsipër të tregtojë në Republikën e Shqipërisë, barnat e mëposhtme të përfshira në Listën e Barnave të Rimbursuara 2024

Kod bari	Principi aktiv	Forma	Emri tregtar

## Për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

..... Emri, Mbiemri dhe firma e Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit

## Për Importuesin Farmaceutik \_\_\_\_\_

..... Emri, Mbiemri dhe firma e personit juridik/fizik, ortak i vetëm/administrator/përfaqësues ligjor